



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION, TË
MBAJTUR MË 26.11. 2013**

**NËNTOR
2013**

Mbledhjen e kryeson anëtari i Komisionit për Legjislacion, z. Armend Zemaj

KRYESUESI: Përshëndetje, zëvendësministër,

Të gjithë ju të tjerët të ftuar që keni shprehur interes që sot të jeni në Komisionin për Legjislacion në dëgjimin publik të organizuar me rastin e Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilët përkufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lejim me kusht.

Në fakt edhe sipas Rregullores së Punës së Kuvendit dhe agjendës së Komisionit, Komisioni është obligativ që të mbaj dëgjime publike me rastin e projektligjeve që kalojnë në lexim të parë.

Dhe, ju siç e dini të gjithë ky projektligj ka kalua në muajin shtator.

Kuvendi e ka përkrahur në parim si pjesë ta quaj të rëndësishme reformës në sistemin e drejtësisë, por edhe duke shprehur edhe opinione të ndryshme të grupeve parlamentare, deputetëve, grupeve të interesit dhe gjithë atyre që merren sidomos me sistemin e drejtësisë, të drejtat e njeriut por edhe avancimin e sundimit të rendit dhe të ligjit në vend.

Ne jo rastësisht kem dashtë që sot të ju ftojme të gjithëve së bashku këtu me sponzorusin, deputetët dhe institucione tjera që merren me çështje të drejtësisë.

Komisioni ka formuar grupin punues që trajton ekskluzivisht këtë projektligj.

Ne kemi fillua me takime, po ashtu kemi fillua edhe me marrjen e opinioneve të ndryshme nga organizata kredibile.

Kemi pasur takime paraprake dhe është një disponim i përgjithshëm që sot t'i trajtojmë edhe në këtë dëgjim publik bashkërisht me ju.

Projektligji i përmendur është dal si kërkesë po thuaj ashtu diçka që ndoshta i ka mungua Kosovës në aspektin e trajtimit serioz sidomos të panelit për lirim me kusht, por edhe çështjeve që eventualisht jo rrallë herë sistemi i drejtësisë sidomos Shërbimi Korrektues, Shërbimi Sprovues ndeshet me ata

që duhet ta respektojnë ligjin por edhe ata që kanë kryer krime dhe janë të dënuar për vepra të ndryshme.

Dilemat ekzistojnë në këtë projektligj nga deputetët, nga EULEX-si, nga Zyra e BE-së dhe nga OSBE-ja.

Sot dëshirojmë që të kemi opinione të juaja të gjithëve edhe nga shoqëria civile edhe nga ata që merren me të drejtat e njeriut sepse është edhe një pjesë e rëndësishme këtu që flitet, sidomos me nene të caktuara, por edhe me rregullat e Këshillit të Evropës sa i përket masat për monitorimin e personave që janë të liruar me kusht apo për dënimet e ndryshme.

Ju do ta keni rastin sot që të diskutoni. Ju kisha lutë që të jeni racional në kohë dhe lutja e dytë është që ato që dëshironi t'i shprehni si opinione t'i leni me shkrim që Komisioni ta vazhdoj punën së bashku me grupin punues dhe me të gjitha palët tjera që kanë shprehë interes që janë pjesë e këtij projektligji që të punojnë dhe të shohim se cili do të jetë vendimi përfundimtar.

Ne kemi pas dy tri çështje që janë ngrit këtu:

E para, është një projektligj i ri dhe diçka e re që futet në sistemin tonë të drejtësisë.

E dyta, ka disa projekte që janë në procedurë sa i përket Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues nga Komisioni Evropian,

E treta, dilema e partnerëve ndërkombëtarë se vendet tjera të cilat e kanë këtë projektligj apo së paku kanë tentuar ta futin në praktikë, kanë pasur problem në implementim.

Dhe e fundit që Kosovën e përcjell por edhe ligjet në tërësi është kostoja e madhe për implementimin e këtij projektligji dhe pikëpyetja se a do të ketë buxhet apo a ka buxhet të mjaftueshëm për zbatimin e tij.

Këto janë katër çështje kryesore pa dashtë me hy në bërthamë dhe me ju marrë juve kohën.

Unë ju kisha lutë që ata që dëshirojnë që të jenë pjesë e diskutimit le të paraqiten. Unë fjalën po ja japë sponsorizuesit, zëvendësministrit që është

këtu në emër të Ministrisë së Drejtësisë dhe në emër të Qeverisë së Kosovës.
Faleminderit, shumë!

ZËVENDESMINISTRI DAUT XHEMAJLI: Faleminderit, kryetar Zemaj!

Të nderuar anëtarë,

Dhe ju të pranishëm,

Më lejoni që të paraqes para jush disa çështje të përgjithshme që kanë për qëllimin, rëndësinë dhe përmbajtjen e Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja apo liria me vendim të gjykatës ose të panelit me lirim me kusht.

Ministria e Drejtësisë në bazë të programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013 ka hartuar këtë projektligj në kuadër të prioritetëve për reformimin e sistemit të drejtësisë si dhe për përforcimin e kapaciteteve të Shërbimit Sprovues të Kosovës.

Qëllim primar i këtij projektligji është rritja e sigurisë publike dhe garantimi i ekzekutimit efektiv të vendimeve të gjykatës dhe të panelit për lirim me kusht përmes rregullimit me ligj të përdorimit të mbikëqyrjes elektronike përgjatë procesit të zbatimit të drejtësisë penale.

E gjithë kjo duke respektuar plotësisht dhe në çdo kohë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave të përfshirë në mbikëqyrje elektronike.

Ky projektligj do të zbatohet për mbikëqyrjen elektronike të personave ndaj të cilëve me vendim të gjykatës është vendosur masa e sigurimit, pranisë së të pandehurit si premtimi i të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin, ndalimit për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar, rreshtit shtëpiak dhe dënimeve alternative siç janë:

- dënimi me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues,
- dënimi me kusht me urdhër për mbrojtje nga Shërbimi Sprovues,
- mos ndërrimi i vendbanimit pa e informuar Shërbimin Sprovues,
- heqja dorë nga frekuentimi i vendeve apo i lokaleve të caktuar, dhe
- gjysmë lirie.

Në kuadër të këtij projektligji është paraparë edhe mbikëqyrja e personave ndaj të cilëve është shqiptuar urdhri mbrojtës dhe urdhri për mbrojtjen në lëndë.

Organi përgjegjës për realizimin e mbikëqyrjes elektronike do të jetë Shërbimi Sprovues i Kosovës, shërbim ky i cili sipas Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale është shndërruar në organ qendrorë dhe të pavarur nga Ministria e Drejtësisë. Për më tepër mbikëqyrja elektronike do të zbatohet duke u bazuar në dispozitat e Kodit Penal, Kodit të procedurës penale dhe Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Si dhe do të ketë parasysh shumë parime esenciale siç janë:

- parimi i ligjshmërisë,
- mbrojtjes së rendit, dhe sigurisë publike,
- garantimi i lirisë personale të të dëmtuarit nga vepra penale apo të viktimës,
- respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut,
- mos diskriminimi,
- proporcionaliteti i mbikëqyrjes elektronike me rrethanat e rastit, dhe
- personalitetin e personit si dhe parimin e objektivitetit dhe efektivitetit në këtë rast.

Mbikëqyrja elektronike është metodë e re që garanton zbatim efektiv të vendimeve gjyqësore dhe të panelit për lirim me kusht përmjet përcaktimit të vendndodhjes së saktë të personit të dënuar me anë të përdorimit të mjeteve elektronike të vendosura në trupin e tij.

Kjo do të thotë që këto mjete vendosen në vende të padukshme siç e keni pa në ligj dhe që nuk kanë asnjë efekt. Domethënë pa e vendos personi në një institucion korrektues apo të paraburgimit.

Si i tillë zbatimi i mbikëqyrjes elektronike krijon edhe një mundësi më shumë për alternativë të burgimit e cila në një mënyrë do të ndikojë edhe në zvogëlimin e numrit të të burgosurve nëpër burgje dhe në qendrat e paraburgimit.

Kjo formë sidomos do të përfshijë personat me dënime afatshkurtra, rrezikshmëria e të cilëve ka mundësi të kontrollohet përmes kontrollimit të lëvizjes së tyre në territore të caktuara.

Kjo pa tjetër se do të reflektoj edhe në rritjen e sigurisë në shoqëri si dhe zvogëlimin e kostos buxhetore për personat të cilët janë dënuar me një vendim gjyqësor dhe duhet të ekzekutohet masa apo dënimi i shqiptuar për vuajtje të dënimit apo masës nëpër institucionet korrektuese.

Çdo tendencë për kryerjen e veprës së re penale apo mosrespektim të rregullave do të neutralizohet menjëherë nga organet për zbatimin e ligjit, respektivisht Policia e Kosovës e cila do të jetë e informuar menjëherë apo automatikisht përmes qendrës së mbikëqyrjes.

Përmes kësaj forme të mbikëqyrjes këta persona do të jenë në mbikëqyrje të përhershme dhe të vazhdueshme dhe kjo do të shërbej që të evitohet çdo shkelje eventuale që do të cenonte dhe rrezikonte sigurinë e personit dhe personave të tjerë.

Rëndësi tjetër e projektligjit që patjetër, mendoj më që duhet të ceket është fakti se me këtë ligj do të inkurajohet shqiptimi i më shumë masave alternative dhe dënimeve me kusht.

Në raport me masat e paraburgimit dhe dënimeve me burgim. Mirëpo gjithmonë vetëm për rastet kur e parashohin ligjet në fuqi dhe të vendimeve të organeve kompetente gjyqësore.

Para se të përfundoj më duhet të shtoj se ky projektligj është hartuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim të ngushtë me institucione kompetente dhe përgjegjëse për zbatim të këtij projektligji dhe në finalizimin e tij kanë dhënë kontribut të çmuar edhe EULEX-si, edhe institucionet tjera ndërkombëtare në Kosovë. komentet e të cilave janë shqyrtuar me kujdes dhe janë inkorporuar në ligj me po aq kujdes.

Ky projektligj përmban pesë kapituj me gjithsejtë 21 nene, për të cilat edhe më tutje ne jemi të gatshëm të shqyrtojmë dhe të inkorporojmë në ligj komentet e juaja për qartësimin dhe eventualisht të korrigjimeve të nevojshme nga grupet punuese. Ju faleminderit për vëmendjen tuaj dhe jemi në dispozicion për çfarëdo interesimi.

Këtu me vete kemi edhe zyrtarë ligjor që kanë punua konkretisht në këtë ligj edhe përfaqësues nga Shërbimi Spronues i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zëvendësministër!

Ju dëgjuat sponsorizuesin të gjithë. Keni dëgjuar edhe Kuvendin në fjalën e vetë në seancën plenare. Besoj që pa dashtë me i përsëritë edhe ato çka i thash paraprakisht, ndoshta do të ketë edhe pyetje për zëvendësministrin dhe zyrtarët ligjor të Ministrisë së Drejtësisë. Ka pasur edhe disa dilema tjera që janë ngritur nga deputetët e dëshiroj që janë pjesë edhe të këtij debati sepse mendoj që çështjet kryesore janë lënë që të nxirren në akt nënligjor nga Ministria e Drejtësisë dhe për mendimin tim janë disa çështje që duhet të precizohen konkret dhe mos me i lënë hapësirë për interpretim apo mundësisht që ka edhe elemente të keqpërdorimit në të ardhmen, siç janë Qendra e vendosjes së mbikëqyrje domethënë dhe pjesë tjera të implementimit sidomos me kompetencat e shtruara për Shërbimin Sprovues të Kosovës.

Urdhëroni,

... fjalën e keni, kush dëshiron? Urdhëro! Ju lutem, çdonjëri prezantohuni!

Haxhi Dërguti : Jam përfaqësues i Prokurisë së Shtetit të Kosovës.

I nderuar kryetar,

Të nderuar të pranishëm,

Prokuroria e shtetit nga iniciativa e parë për hartimin e këtij projektligji ka marrë pjesë aktive, së bashku me administrimin e drejtësisë dhe unë kisha me e përgëzua, fillimisht Ministrinë e Drejtësisë, që na ka sponsorizuar një ligj që është shumë i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë penale në Kosovë. Këtë projektligj ne e përkrahim për dy arsye:

E para, sepse për herë të parë në Kosovë po aplikohet masa e mbikëqyrjes elektronike të personave, të cilëve u kufizohet liria e lëvizjes, me vendim të Gjykatës dhe panelit për lirim me kusht.

Dhe e dyta, se me këtë ligj do të mundësohet efikasiteti i zbatimit të vendimeve të gjykatave dhe të panelit për lirim me kusht.

Ky ligj është i një rëndësie të shumëfishtë, pasi që do të mendojë që sistemi gjyqësor dhe prokuroria i Kosovës të sigurojnë prezencën e të pandehurit në procedurën penale.

Në praktikën e gjertanishme të prokurorisë, në mungesë të një mase të tillë për sigurimin e prezencës së të pandehurit në 90% të rasteve nga Prokuroria e Kosovës kanë propozuar masën e paraburgimit, si masë më të rëndë për sigurimin e prezencës së pandehur në procedurë penale.

Mirëpo, kjo arsye pse kemi kaq një propozim kaq të madh në përcaktim të paraburgimit, për shkak se gjithherë prokurorët kanë konsideruar që nuk kemi masa efikase, domethënë që përveç paraburgimit që të sigurohet prezenca e të të pandehurit në procedurën penale. Dhe, si pasojë e kësaj ne kemi një stërngarkim të burgjeve, gjegjësisht të qendrave të paraburgimit në Kosovë.

Pse prokurorët nuk kanë propozuar më shumë masa alternative, siç janë për shembull arresti shtëpiak, ose propozimi ose qëndrimi i të të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin ose vendzbatimin, për shkak se zbatimin e arrestit shtëpiak gjer më tani e ka zbatuar, domethënë mbikëqyrjen e zbatimit të masës të cilën e ka caktuar gjykata, e ka zbatuar Policia e Kosovës, për të cilët në shumë raste në praktikë jemi ballafaquar me probleme të ndryshme, që kanë të bëjnë me moszbatimin e asaj mase, për shkak se policia nuk ka pasur resurse njerëzore që 24 orë të bëjnë mbikëqyrjen e zbatimit të atyre masave, sidomos të masës së arrestit shtëpiak.

Përveç kësaj do të krijohet mundësia më e madhe me këtë ligj, që të shqiptohen edhe masa të tjera, siç është për shembull premtimi i të të pandehurit, se nuk do ta braktisë vendqëndrimin dhe me vendosjen e këtyre masave, të cilat janë propozuar me ligj, atëherë do të sigurohet një prezencë më e madhe, domethënë një siguri më e madhe, se personat e tillë nuk do të largohen nga vendqëndrimi.

Pse, domethënë Prokuroria në shumicën e rasteve propozon masat e paraburgimit? Për arsye se deri më tani praktika ka treguar, që ky sistem domethënë, nuk kemi pas një sistem efikas të mbikëqyrjes. Domethënë, të sigurimit të prezencës të të pandehurve dhe në këtë aspekt ne konsiderojmë se me këtë projektligj do të mundësohet dhe do të zvogëlohet numri i personave, ashtu siç tha edhe zëvendësministri, i personave të cilët gjenden në paraburgim, do të zbatohet në mënyrë efikase vendimet e gjykatave për këto masa të shqiptuara, policia e Kosovës nuk do të ketë mbikëqyrje si gjer më tani, arrestin shtëpiak, por do t'i vendosin masat dhe në bazë të asaj do të

kontrollohet çdo lëvizje e personit, të cilit i vendoset masa dhe prokurorët dhe gjyqtarët do të aplikojnë më shumë masa alternative si është prezenca e sigurisë së të pandehurve, siç është për shembull arresti shtëpiak dhe premtimi i të pandehurve se nuk do ta braktisin vendqëndrimin.

Po ashtu, do të kemi edhe një efikasitet më të madh në zbatimin e vendimeve të panelit për lirim me kusht, që në praktikën gjyqësore ka ndodhur te ne, që personi është liruar me kusht, pas një kohe ka lëshuar Kosovën, ka shkuar jashtë shtetit, kështu që nuk ka pasur mundësi që shërbimi sprovues me e përcjellë personin, ndaj të cilit është aplikuar lirimi me kusht.

Prandaj, ne si prokurori e shtetit në tërësi e përkrahim këtë projektligj dhe i propozojmë Kuvendit që të njëjtin ta aprovojë, edhe pse sipas kësaj që shihet se do të ketë implikime buxhetore, por me siguri që do të gjenden mjetet dhe ky ligj do të miratohet sa më shpejt dhe do të fillojë zbatimi i tij, ashtu siç është paraparë nga 1 janari i vitit 2015. Faleminderit për vëmendjen tuaj!

KRYESUESI Faleminderit, zotëri prokuror! Urdhëroni!

BEHXHET SHALA: Faleminderit! Jam Behxhet Shala. E përfaqësoj KMDLNJ-ën. Unë kam më së pari një dilemë, a po i miratojmë ne ligjet, të cilat i shërbejnë këtij vendi, të cilat janë të zbatueshme, apo miratojmë ligje vetëm sa për ta përmbushur planin e miratimit të ligjeve, sepse ky ligj, pothuajse mund të funksionalizohet në vitin 2015, unë mendoj që në rastin më të mirë ky mund të jetë funksional në vitin 2020, jo më herët. Nuk besoj se ka gjasa më herët!

Mirëpo, kam edhe një dilemë tjetër. Në qoftë se, ky ligj e ka një kuptim, ose në qoftë se mbikëqyrja elektronike bëhet me një vendim të Gjykatës, me një procedurë paraprake, nuk e di pse do të duhej këtu të implikohej paneli për lirim me kusht!? Aq më parë, kur dihet shumë mirë se kush mund të jetë përfitues nga paneli për lirim me kusht dhe njeriu, i cili përfiton nga paneli për lirim me kusht, nuk mund të ketë kufizime pasi që të dalë nga burgu, me përjashtim kur ka kufizime, që në afat të caktuar të mos kryejë ndonjë vepër penale. Do të thotë, ajo është i vetmi kufizim dhe mendoj se ata të cilët lirohen nga paneli për lirim me kusht, vihen në pozicion që u shkelen të drejtat e njeriut, u kufizohet liria e lëvizjes, privatësia, diskriminohen... kjo nuk ka asnjë dyshim. Dhe, mendoj se duhet të bëhet një prerje e qartë midis

vendimit të Gjykatës, sepse kjo masë nuk mund të shqiptohet edhe aq shpesh, kjo masë nuk mund të zëvendësojë as arrestin shtëpiak, as masat tjera alternative.

Pra, duhet të bëhet një prerje e qartë midis vendimit të një gjykate dhe vendimit të panelit për lirim me kusht, sepse i dënuari i cili përfiton nga paneli për lirim me kusht, ai e kalon tërë procesin e risocializimit, domethënë ai duhet të dëshmojë se ka të drejtë ta fitojë lirinë, e cila është e kushtëzuar vetëm me atë që të mos kryejë vepra në një afat të caktuar, jo për shembull, mos të lëvizë andej, mos të lëvizë këndeje... Kjo nuk ka, aty nuk parashihet... unë nuk e di që paneli për lirim me kusht e ka lëshuar një vendim, ku dikujt i kufizon lirinë e lëvizjes, apo diçka të ngjashme. Absolutisht, kjo nuk mund të ndodhë, sepse ne e kemi mbikëqyrur punën e panelit për lirim me kusht dhe nuk ka asi rastesh. Por, në fund të fundit, edhe ky panel liron shumë pak të dënuar, domethënë është një numër më tepër simbolik, se sa që janë përfituesit realë.

Pastaj, ky ligj nuk e parandalon veprën penale. Absolutisht, nuk është asnjë garancion, që në qoftë se dikujt ia vendosin një mjet elektronik, ai nuk do ta kryejë një vepër penale. Nuk është kjo asnjë garanci. Mund vetëm ta identifikojë vendin se ku është, përndryshe nuk parandalohet vepra penale.

Ky ligj duhet të jetë si rezultat i shqiptimit të masave alternative të dënimit, jo për shembull, që ky ligj e ndihmon që të ketë më shumë masa alternative, po thjeshtë së pari duhet të shqiptohen masat alternative të dënimit, pastaj mos të zbatohet ky ligj. Ky ligj nuk mund t'i paraprijë masave alternative të dënimit dhe nuk është kusht për këto masa.

Prandaj, edhe në aspektin e të drejtave dhe të lirive të njeriut, ky ligj me këtë përmbajtje që ka është kufizues, është diskriminues dhe si i tillë nuk mund të pranohet. Mund të ndryshohet, por si i tillë nuk mund të pranohet, në veçanti thjeshtë nuk mund të përfshihen personat e liruar nga paneli për lirim me kusht apo ata të barazohen me këta, të cilëve u shqiptohet kjo masë me një vendim gjykate në procedura paraprake, ose derisa të merret një vendim përfundimtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëroni, zonjë!

SHQIPE IBRAJ – MALAJ : Faleminderit! Unë jam Shqipe Ibraj – Malaj, jam zëvendëse e Avokatit të Popullit. Faleminderit për ftesën!

Unë e kam analizuar pak ligjin, kam qenë në pushim mjekësor fatkeqësisht, s'kam... Megjithatë, kam shikuar dhe një përvojë të ngjashme, ma merr mendja, se ligji si ligj është marrë, besoj, si model i Shqipërisë. Ne, në maj të këtij viti, ishim në vizitë në disa burgje të Shqipërisë dhe patëm një takim me ministrin e Drejtësisë, i cili prezantoi aplikimin e kësaj mase.

Nuk kam dhënë ndonjë koment ose rekomandim me shkrim. Në një pikë, te e cila isha dashtë me u ndalë, është neni 8, ku e kufizon kohën, thotë: “Afati i kohëzgjatjes së mbikëqyrjes elektronike nuk mund të jetë më i gjatë se një vit.” Nëse flasim ndoshta, veç për vendimet e Gjykatës, siç e shpjegoj edhe prokurori, që kanë të bëjnë me vendimet alternative, atëherë ndoshta do të mund të vlente, por nëse flasim për vendimet e panelit për lirim me kusht, ndodhë që paneli për lirim me kusht jep vendime edhe për një kohë më të gjatë se sa një vit.

Behxheti pak e përmendi, unë prej vitit 2009 kam monitoruar panelin për lirim me kusht, kam monitoruar punën e tyre dhe sa i përket përbërjes së panelit për lirim me kusht, edhe në përbërjen e kaluar mirëpo, edhe me ligjin e ri, siç parashihet, megjithatë, unë e kam një këndvështrim tjetër prej një përvoje tjetër. Mendoj që paneli për lirim me kusht duhet me qenë një institut i pavarur dhe jo me qenë të njëjtit gjyqtarë ose prokurorë që punojnë të njëjtën detyrë, të kryejnë dy detyra fatkeqësisht, se bien ndesh shumë shpesh gjatë punës me njëra tjetrën.

Nuk e di në këtë drejtim, shërbimi sprovues dhe ajo që ka ofruar shërbimi sprovues, unë mendoj, që ndoshta ligji si ligj do të ishte më mirë sikur të shikohet se si po implementohet në Shqipëri, sa po është i suksesshëm atje, pa hyrë në ato komplikimet e buxhetit dhe mundësitë tjera. Mendoj, që ishte dashur ndoshta të jepet një fuqizim më i madh shërbimit sprovues, në këtë drejtim në punën dhe detyrat që i ka për momentin, para se t'i jepet edhe një detyrë shtesë me monitorimin elektronik.

Ideja si ide dhe qëllimi si qëllim dhe ligji si ligj, unë mendoj se është shumë i vlefshëm dhe shumë i nevojshëm, mirëpo për momentin, unë kam frikë se mundet me qenë pak i hershëm dhe s'e di 2015-ta a kishte mujt me qenë kohë që kishte me mujt me fillu monitorimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit shumë! Unë po e jap një mendim të Kuvendit, në këtë aspekt të Komisionit, sepse detyrë e jona është që me të vërtetë të nxjerrim ligje të zbatueshme dhe që janë të implementueshme në praktikë. Dhe, angazhimi ynë është rregullimi i sistemit në përgjithësi, sepse shembuj të këqij kemi të mjaftueshëm. Por, arsyeja që sot po e diskutojmë është, që të nxjerrim një projektligj që i ndihmon sistemit të drejtësisë, duke filluar edhe atë që tha prokurori, sepse ne dëgjojmë zakonisht shpesh, ka edhe raporte zyrtare, që prokurorët më shumë i caktojnë paraburgimet përmes telefonit, se sa janë në vendin e ngjarjes. Dhe, për këtë arsye është një prej atyre, që quhet mbipopullim edhe i burgjeve.

E dyta, unë kisha dashur me e dëgjua zyrën e Komisionit Evropian, nuk e di a janë këtu, apo edhe shërbimin sprovues, për një projekt që përfillet se është i binjakëzimit, i cili tenton që ta forcojë shërbimin korrektues sprovues në Kosovë, për dënimet alternative. Dhe, pjesa tjetër, që është pjesa tjetër... Urdhëro!

Celuie Ancouturier : *(Nga përkthimi.)* Unë mund të ju them shkurtimisht për këtë projekt, me të cilin ne e përkrahim. Ky është një projekt, i cili do të fillojë vitin e ardhshëm, do të thotë do të synojë forcimin e të dyja këtyre shërbimeve. Në këtë çështje kemi diskutuar nëpër forume të ndryshme, për këtë iniciativë dhe vlerësimi ynë është, se shpenzimet edhe teknologjia që kërkohet për vëzhgimin elektronik nuk është e mundshme të këtë periode dhe kjo do të sfidojë projektin tonë që do ta fillojmë vitin e ardhshëm, sepse ne do të mundohemi që t'i forcojmë resurset e shërbimit sprovues dhe korrektues, gjithashtu e kemi diskutuar edhe me partnerët e tjerë se nuk ka ndonjë resurs apo burim tjetër që parashihet për përkrahjen e projektit të vëzhgimit elektronik.

Përmes projektit tonë ne do të mundohemi që t'i trajtojmë sfidat siç është kategorizimi i të burgosurve, krijimi i databasës qendrore të të burgosurve, përkrahja e shërbimeve sprovuese në programet e tyre ... dhe kjo do të jetë ajo që do të bëhet gjatë dy vjetëve të ardhshme prej këtij projekti tonë.

KRYESUESI: Faleminderit, shumë!
Urdhëro dikush tjetër? Urdhëro.

JON SMIBART : (diskutimi nga stimulant)

Mirëmëngjesi! Unë vij nga Departamenti i Drejtësisë, i Ambasadës Amerikane. Faleminderit që më keni ftuar.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë përvojë shumë në vëzhgime elektronike prej viteve ‘80, kemi shumë juridiksione të cilët e kanë zbatuar këtë. Është një sistem që është zbatuar në mënyra të ndryshme në tërë SHBA-në mund të ju shkëmbej disa përvoja që i kemi pasur dhe disa rezultate, të cilat duket se kanë ardhur nga këto përvoja. Një gjë që mund të ndajmë me ju është një proces i shtrenjtë, sepse teknologjia tani është gjithnjë duke u përmirësuar dhe shërbime për këtë teknologji disa studime në sistemin federal kanë thënë që kushton 11 dollarë në ditë për një person, vetëm për personin e burgosur duke përjashtuar këtu personelin që punon në shërbimin e sprovimit dhe korrektimit.

Do të thotë, kjo ka një kosto të madhe në drejtësinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kështu që kjo 11 dollarëshi në ditë duhet të paguhet dhe kjo do ta pengonte ekonominë, shkakton probleme me barazinë. Nëse lihet kjo anash dhe shpenzimet anash, është një ndryshim fundamental për mënyrën se si punon shërbimi sprovues.

Në SHBA ne kemi sistemin federal dhe ato lokal nëpër shtete dhe nëpër komuna, të cilat i kanë këto sisteme ata kanë bërë një udhëzues 200 faqe për të gjitha këto shërbime të cilat ju kërkojnë atyre të bëjnë udhëzime tjera për panelin për lirim me kusht që të jenë në gjendje të bëjnë këtë monitorim, këtë vëzhgim.

Çdo shërbim sprovues që i ka zbatuar këto, që edhe ka shumë prej tyre që i zbatojnë këto, por kanë bërë përgatitje të mëdha para zbatimit por madje edhe pas këtyre përgatitjeve ka pasur ngarkesë të madhe për shpenzimin e provimit sprovues që në Kaliforni për shembull që është pak a shumë madhësia e njëjtë sikur me Kosovën, për secilin prej këtyre që kanë kryer vepra dhe që kanë vendosur në këtë sistem përmes sistemit DPS që duket që ky sistem do të përdoret edhe këtu janë 19 alarme për këtë që të bëhet kjo gjë, sepse kërkon plus linja telefonike, plus gjëra të tjera.

Dhe këto në detale të tjera, të cilat përfshihen në këtë sistem. Një komentator ka thënë që ndonjëherë vëzhgimi monitorik elektronik nuk e zvogëlon krimin. Ka pasur raste kur edhe njerëzit që kanë pasur këtë pajisjen dhe kanë kryer krime. Kur them këtë është se ky është një sistem që

zvogëlon dhe mundëson paraburgime më të ulta, numër domethënë më të vogël të paraburgimeve. Gjithashtu edhe zvogëlimin e viktimave.

Këto janë dy gjërat të cilat desha të ju jap juve dhe ta informoj komisionin që ta balancojë, që ju ta merrni parasysh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, shumë për kontributin!
Urdhëroni.

DECLAN O'MAHONY: (diskutim nga stimulantit)
Faleminderit! Unë quhem Deklan O'mahoni nga EULEX-i kryesues ne kemi dorëzuar disa komente te ju me shkrim dhe ne nuk preferojmë që t'i përsërisim ato që i kemi thënë po me lejen tuaj ndoshta mund t'i japim disa komente tjera për atë çka dëgjuam më herët.

Dua t'ju falënderoj juve dhe kolegët e juaj për kohën që e keni kaluar dhe që i keni jap rëndësi kësaj çështje. Faleminderit, shumë juve dhe kontribuuesve të tjerë.

KRYESUESI: Ne kemi marrë me shkrim atë që është paraqit si opinion i juaj nëse dëshironi që të keni diskutim shtesë urdhëroni fjalën e keni, besoj se edhe kolegët tjerë janë të disponueshëm për me dëgju opinionin e juaj.

DECLAN O'MAHONY: Faleminderit! Nëse mund të sintetizoj atë çka e kemi thënë dhe atë që e kemi dëgjuar sot, shpenzimet implikimet për shpenzime për këtë projekt për këtë program nuk janë marrë parasysh tërësisht, shpresoj që komisioni kur t'i vlerësojë vlefshmërinë e ligjit do të insistojë më shumë në një pamje më të qartë se cilat do të jenë shpenzimet.

Kam kuptuar pozita apo është me milionë euro, por ky numër kjo shifër nuk është llogaritur mirë mendoj që ka shpenzime shumë më shumë se sa thuhet në ligj, në atë shtetin Amerikë që kanë qenë 19 thirrje në ditë kjo do të thotë që duhet të keni persona të mjaftueshëm me vetura të mjaftueshme, me zyra të mjaftueshme, që të jenë në gjendje që të shkojnë në çdo vend të Kosovës ku njerëzit që e kanë këtë pajisje mund të ikin apo të dalin jashtë rrethojave, kështu që këto shpenzime kjo kosto duhet që të llogaritet edhe njëherë më mirë dhe të qartësohet më mirë.

Nëse jeni të gatshëm të të shpëtoni paratë e njerëzve për këtë ligj. Unë pajtohem me atë çka u tha për afatin kohor, gjithashtu për kohën mendoj që është shumë optimiste nëse do të fillohet me këtë procedurë. Është përgjegjës shërbimi sprovues që njerëzit mund të bëjnë prapë krime dhe pasi të vendosin këtë pajisje.

Ju do të keni njerëz, të cilët duhet të bëjnë gjykime profesionale nëse duhet të lejojnë njerëzit apo jo. Mendoj që është çështje e drejtësisë për ta se sa të drejtë janë ata dhe duhet të kenë aftësitë e duhura, përkrahjen institucionale që t'i lejohet atyre t'i marrin ato vendime në atë mënyrë që nuk i lejon dhe nuk i dëmton qytetarët e tjerë të Kosovës. Dua të përsërisë se është një projekt i cili do të fillojë rishtazi brenda një kohe të shkurtë, ndoshta ky komision duhet të mendojë nëse ai projekt është mjet i duhur që të përkrahë institucionet që duhet ta bëjnë këtë punë para se të fillohet me këtë ligj.

Kështu që unë mendoj që ideja për këtë ligj është e mirë, por ndoshta nuk është një ide që duhet të zbatohet në periudhën të cilën tash parashikohet nga ministria. Kjo është sinteza e saj që desha të bëj ndërmjet asaj që kam thënë më herët dhe asaj që dëgjova sot.

Ka disa çështje tjera, të cilat dua t'i bëj me shkrim tek ju.

KRYESUESI: Faleminderit, shumë! Urdhëro, po.

DECLAN O'MAHONY: desha vetëm të bëj të qartë se studimi i Kalifornisë nuk ka qenë 19 në ditë, por ka qenë 19 në ditë për çdo person, të cilin ka qenë i monitoruar, domethënë 19 alarme në ditë për person.

Kjo përfshin për shembull dështimin e baterive, dështimin që të lidhet me sistemin e telefonave mobil, gjithashtu edhe dështimet e tyre si zinxhir që vendosen si pajisje që vendosen në... vetëm desha ta qartësoj këtë numërin 19. Se nuk është 19 prej krejt ... ,, por 19 në ditë për person .

KRYESUESI: Faleminderit, shumë!
Deputeti Ardian Gjini e ka fjalën

ARDIAN GJINI: Faleminderit, Armend!
Faleminderit të gjithëve domethënë që jeni këtu.

E para e punës kryesisht nuk ka pasur politikë rreth këtij ligji në Kuvendin e Kosovës, domethënë duhet të jemi të qartë, nuk ka pasur ndarje politike ose ideologjike çfarëdo lloji.

Deri tash përkundër faktit që sot nuk i kemi përfaqësuesit e dy partive më të mëdha në pushtet në këtë panel edhe Armendi edhe unë jemi në opozitë, Gëzimi është në Koalicion. Sidoqoftë po më duket që ne kemi nevojë për me marr më tepër kohë për me proceduar me këtë ligj ekzakt për shkak se nuk ka politikë sa po e shoh unë. Mendoj se edhe grupi punues edhe komisioni duhet me marr pak kohë më tepër me Ministrinë e Drejtësisë edhe me institucionet tjera, me prokurorinë, me gjykata edhe me pa si mundemi me e proceduar më tutje.

Një çështje tjetër është se kish me qenë tepër mirë për ne, tepër ndihmuese për shkak se nuk ka politikë për momentin në këtë ligj, me marr propozime konkrete në një afat sa më të shkurtë prej të gjitha institucioneve relevante edhe agjencive, edhe institucioneve të pavarura, të gjithë ata që kanë interes me ndihmuar që ky ligj me qenë sa më i mirë.

Kur po them propozime konkrete mendoj se duhen me të vërtetë me qenë konkrete për me mujt me marr na një tërësi të propozimeve edhe atëherë me mujt me pa se çka me bë me ligj më tutje. Prej asaj çka dëgjova propozimet shkojnë prej disa ndryshimeve që kanë të bëjnë me panelin deri te disa sugjerime implicite që ndoshta edhe ligji nuk është mirë me kalu në këtë kohë.

Domethënë, nëse e kuptova mirë kish domethënë ide implicite që ndoshta nuk është mirë me kalu, por është mirë me i marr sugjerimet na me i dhënë na vetes pak kohë, me i kërkuar ndoshta me shkrim përmes kryetarit të komisionit ose edhe udhëheqësit të grupit punues krejt në rregull është e njëjta gjë edhe po më duket që as komisioni as Kuvendi nuk ka nevojë mu ngutë me këtë çështje, të paktën me e marrë edhe pak kohë derisa t'i sqarojmë të gjitha këto tema të cilat i kemi. Sidoqoftë, kjo që fola unë është më tepër një punë që ne duhet ta bëjmë si komision, mirëpo po dua me thënë se krejt çka dëgjuam sot, është jashtëzakonisht e vlefshme dhe ndihmesë për ne, do me thënë qëllimi kryesor është se duhet me pasur në ligj i cili i ndihmon sistemit të drejtësisë në Kosovë, jo një ligj i cili e ngarkon ose i cili vetvetiu shndërrohet në fyt të ngushtë që krijon shpresa dhe nuk mundet me i sjellë ato që priten prej këtij ligji. Faleminderit!

SHQIPE IBRAJ – MALAJ : Faleminderit!

Modeli si model pasi që është marrë si model i Shqipërisë, është mendim i jemi pasi që e përcjellë këtë fushë ka tash 8 vite. Shqipëria ka Ligjin për të drejtat e të burgosurve. Unë me këtë ligj po e kam frikën se mos po e kalojmë një hap më tutje po nxjerrim diçka, na sigurisht që po kemi dëshirë me bë më mirë dhe me e lehtësuar punën, mirëpo edhe në anën tjetër ato që i përmendi prokurori, unë nuk mendoj që shqiptimi di dënimeve alternative ose rritja e shqiptimit të këtyre dënimeve, me këtë ligj e lehtëson punën ose ngritë numrin ose e liron numrin e të paraburgosurve ose të burgosurit që janë nëpër burgje. Ligji ju jap mundësi prokurorëve me ua shqiptuar dënimet alternative dhe unë prapë kam frikën se ngarkohet, ka me u ngarkuar për së tepërmi shërbimi sprovues sepse nuk ka amë pasur mundësi as me e përcjellë, ata e kanë mundësinë... Unë edhe në një takim më herët me ministrin e drejtësisë e kemi diskutuar dhe jemi të shqetësuar sa i përket numrit të shqiptimit të dënimeve alternative, numri i të paraburgosurve, numrit të burgosurve. Veç në kohën e zgjedhjeve kam pasur 1300, mbi 1350 i kemi pasur vetëm në Dubravë dhe kategorizimi i tyre për shkak të numrit të paraburgosur, për shkak të këtyre dënimeve alternative që mundet me i shqiptuar prokuroria, unë me çdo respekt për Prokurorinë, nuk po dua me e lënë në faj ose, megjithatë mendojmë se dënimet alternative janë duke u shqiptuar a pak ndoshta kishte qenë mirë me e pa se si po funksionin Shqipëria. Unë planifikoj edhe një vizitë tjetër në Shqipëri se si po funksionin ky sistem ndoshta Shërbimi provues ose edhe ju e keni pasur parasysh gjithë këtë që po i them, mirëpo po e kalojmë një hap tjetër, një ligj tjetër që kishit dashur ndoshta me menduar që ta kemi ligj për të drejtat e të burgosurve që ky kishte mundur mandej me u inkorporuar edhe më lehtë me u zbatuar bashkërisht me atë tjetrin. Faleminderit!

ARMED MUSTAFA: nga Shërbimi Sprovues. Përshëndetje!

Unë dua me u lidhë në lidhje me atë që u ngritën disa herë këtu me një projekti i binjakëzimit të cilin Shërbimi Sprovues së bashku me Shërbimin Korrektues e ka nga Komisioni Evropian për ngritjen e kapaciteteve të këtyre dy shërbimeve.

Dhe ndoshta implikimet që mund të jenë në mes të këtij projekti dhe Ligjit për mbikëqyrjen elektronike. Ajo që mund të them, është se projekti pritet ashtu që tha edhe përfaqësuesja në vitin e ardhshëm, në vitin 2014 dhe ky

projekt në një mënyrë parasheh ngritjen e kapaciteteve të dy këtyre shërbimeve. Ideja është që ne përmes këtij projekti të ngrisim kapacitetet tona në kuptim të programeve që do të risocializimit në mbledhjen e të dhënave dhe databazës regjistrave do me thënë që do të kishin këta në sensibilizimin e opinionit në lidhje me shërbimet sprovuese dhe dënimet alternative dhe në një mënyrë ideja është që deri në kohën ose së paku do me thënë në vitin 2015, Shërbimi sprovues t'i ketë kapacitetet e ngritura e në përgjithësi... për t'i ushtruar detyrat e veta.

Kjo në një mënyrë nënkupton që, nëse i referohemi tash edhe këtij ligji ne shohim projektligji, ne shohim se ky monitorimi elektronik, mbikëqyrja elektronike realisht duhet me u shqiptuar krahas një mase tjetër dhe nuk shqiptohet si e vetme. Pra kjo nënkupton në një mënyrë që ne do me thënë mundësitë tona dhe kapacitet edhe në kuptim të ofrimit të programeve kjo personave të cilat ju i shqiptuat ju japë mundësi që të jenë pjesë e atyre programeve të cilat do t'i kemi ngritur përmes projektit të binjakëzimit. Pra, ne e shohim edhe kështu me planifikimin e buxhetit, kosto buxhetore ne kemi menduar që ta rrisim pak edhe numrin e të punësuarve të cilët ekskluzivisht do me thënë do të jenë në Dhomën e mbikëqyrjes sepse stafin që e kemi tani, normalisht që nuk i përmbushë ata, ai staf duhet të jetë edhe i trajnuar edhe kështu me radhë, por në ndërkohë që kapacitetet sa i përket ofrimit të programeve, ne synojmë që t'i ngrisim përmes projektit të binjakëzimit. Faleminderit!

BEHXHET SHALA: Faleminderit!

Unë dua ta mbaj edhe një shqetësim edhe të jap një arsyetim. Shqetësimi është që në njëfarë mënyre mbikëqyrja elektronike mund të kushtëzohet për shembull një i dënuar apo një i cili përfiton nga paneli për leje me kusht me kusht, ai mund të kushtëzohet me futjen në këtë regjim, në qoftë se nuk pranon, atëherë paneli për lirim me kusht mund të mos e lirojë, do me thënë kjo është në njëfarë mënyre bie njëfarë shantazhimi që nuk është në rregull, kjo është e pranueshme, është një shkelje e rëndë e drejtave të njeriut por edhe këtu nuk shihet që ka mekanizma të cilat e monitorojnë këto masat e shqiptuara, nuk ka... e monitorojnë thjeshtë dhe e përcaktojnë nëse ajo masë është shqiptuar si duhet dhe kjo duhet të precizohet me ligj këtu, kjo duhet të saktësohet se kjo është e thjeshtë vetëm në vija të trasha të ligjit, na duhet ende të punohet më tej.

E data, te buxheti. Buxheti nuk do të duhej të paraqes shumë problem. Pse? Kosova në kushtet më optimale i ka 1800 të paraburgosur, të dënuar apo ata ... u shqiptuar një masë qoftë ari... qoftë të tjerë, do me thënë nuk e di se në këto vitet e pas luftës e ka kaluar këtë shifër prej 1800 personave, prej 180 personave vetëm një numër shumë i vogël mund t'i nënshtrohet këtij ... jo të gjithë, prandaj mendoj se është aq më parë që zotëriu tha, i përmendi 11 dollarë apo 90 dollarë, për neve një i burgosur na kushton 25 euro së paku, do me thënë edhe leverdia ekonomike është shumë në favor të këtij ligji se sa rufuzive, do me thënë nuk është ajo.

Pastaj zotëriu, EULEX-i tha që duhet me ... shuka në secilin vend, ai nuk shkohet në secilin vend sepse ka mundësi të largohet patrulla e policisë, largohet dikush, ka mundësi kur e ki që nuk ka nevojë me shkua do me thënë prej Prishtine me shkua në Gjakovë me e arrestua ose me e ndaluar një person. Do me thënë leverdia ekonomike është në favor të këtij ligji sepse kemi pak edhe të burgosur, na kushton shumë. Unë e përmenda 25 euro vetëm ajo çmimi mesatar plus në qoftë se hyjnë aty jo strehimi, jo transferimi, jo problemet e ndryshme që mund ta rrisin koston e qëndrimit të një të burgosurit gjatë në burg.

Në anën tjetër jam shumë i sigurt që Shërbimi Sprovues i cili duket se do të ngarkohet me këtë ... e këtij ligji, nuk ka kapacitete as personale, as njerëzore që ta bëjë zbatimin këtij ligji, sikur që nuk ka kapacitete sepse Shërbimi Sprovues e tash po ka probleme në përcjelljen e atyre të cilët lirohen ose tjetrit nuk është në gjendje ende me e përmbushur mandatin që e ka. Prandaj, në radhë të parë duhet të punohet shumë në forcimin e Shërbimit Sprovues pastaj të mendohet që t'ju ngarkohet edhe një barrë që nuk mund ta kryejnë për këtë arsye thash. Unë nuk e pata parasysh buxhetin kur thash se ky ligj është i pazbatueshëm para vitit 2020, madje edhe 2020 është mirë kështu që ne i kemi dy mundësi ose ta bëjmë një ligj vetëm që të themi se i kemi përmbushur rendin e ditës për miratimin e ligjeve ose të presim pak dhe ta bëjmë një ligj i cili do të jetë i zbatueshëm dhe i cili do të ndikoj, do të ndihmoj edhe Prokurorisë edhe gjyqësorit dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës edhe Shërbimit Sprovues dhe më qëpari duhet të provohet me masat alternative. Këtu nuk ka masa alternative, arresti shtëpiak absolutisht nuk është masë alternative sepse nuk ka kapacitete me e mbikëqyrë personin që është në arrest shtëpiak, shkohet në shtëpi ose banesë një herë në 4-5 ditë, policia e këqyrë nuk është, del gruaja thotë po këtu është, ashtu që nuk ka masa efikase për mbikëqyrjen ... ose nuk

shkojnë fare, në shumë raste nuk shkojnë fare. Unë e di në Kosovë deri tash pas vitit '99, vetëm policia ka ndejtë te dera e Albin Kurtit në banesë kur iu është shqiptuar masa e arrestit shtëpiak e paraburgimit sepse ai ikte. Nuk rrihe.... me masa alternative, ka këtu punë të dobishme për shoqërinë. Dënimet plotësohen, ka shumë masa tjera derisa t shkohet te kjo, kjo është për neve është një çështje një sfidë që për vete nuk e përballoj këtë.

KRYESUESI: Po, nëse nuk ka dikush tjetër, një përmbledhje kisha dashur edhe të gjitha këtu që u diskutuan para se me kaluar fjala...

KRYESUESI: ... Urdhëro, zëvendësministër!

DAUT GJEMAJLI: Unë ju falënderoj për kontributin, komentet dhe të tjera. Nuk është qëllimi im të sqaroj gjithçka që u tha në lidhje me këtë ligj, por e rëndësishme është që ne e kemi pasur parasysh të gjitha këto që u thanë nga të gjithë diskutuesit.

Kemi të bëjmë me një ligj që po mendojmë, Shërbimi sprovues i Kosovës në këtë fazë, e dimë që nuk e ka dhomën, nuk e ka kuadrin e kapacitetit të menaxhojë me këtë, por brenda një viti duhet t'i ketë dhe mund t'i bëjë.

Shërbimi sprovues i Kosovës deri tash rolin dhe detyrat e tij i ka kryer, plus ka kërkuar, do të thotë përmes fushatave që i përmendi edhe përgjegjësi i Shërbimit sprovues, ka kërkuar që në Kosovë gjykatat tona, institucionet tona të shqiptojnë sa më shumë dënime alternative e tjera, e tjera në mënyrë që dënimet të humanizohen.

Fjala është për jo dënime të rënda, jo krime qysh po përmenden që në një formë nuk bisedohet për mbikëqyrje, për lirim me kusht e për persona që mund të jenë kryerës të veprave penale, mund të jenë të rrezikshëm për shoqërinë e tjera. Do të thotë, ne e kemi fjalën për persona që eventualisht në kryerjen e veprave penale, do të thotë, janë persona që nuk paraqesin rrezikshmëri tepër të madhe për shoqërinë, në rast se iu kufizohet liria e lëvizjes në familjet e tyre, në punën e tyre, e tjera, do të thotë që ne atë person e sanksionojmë, por ai është i dobishëm për familjen, e tjera, pra për rrethin në fund të fundit, pra për familjen e vet dhe për veti.

Plus asaj, në person në burgjet tona na kushton, ose në paraqendrat e paraburgimit, pavarësisht, diku rreth 30 euro. Një person brenda vitit na

kushton hiq më pak se nja 10.000 euro. Domethënë, këtu është problemi që në afatgjatë këta persona, ose kjo formë na ndihmon si shoqëri që të na kushtojë më lehtë mbikëqyrja dhe risocializimi i këtyre personave.

Tjetra është që këta persona, ose kjo mbikëqyrje, nuk është e rrezikshme për shëndetin e tyre dhe për rrethin. Në rast se ne personit të caktuar që ka bë dhunë në familje ose tjera, ia kufizojmë që në terrenin apo në territorin e caktuar në Fushë Kosovë nuk mundesh me shkua, do të thotë, në momentin që ai e thyen këtë rregull, për 15 minuta lajmërohet stacioni më i afërt dhe intervenohet që ai të pengohet në kryerjen eventuale të veprës penale. Ne nuk mund të supozojmë se kjo është absolute, por megjithatë ju i dini rastet qysh kanë ndodhur dhe sa i respektojnë njerëzit vendimet e gjykatave, sa kemi mundësi teknike e kapacitete të secilit person në polici apo në Shërbimin sprovues personat të shkojnë pas tyre, e tjera.

A e zvogëlon apo s'e zvogëlon dhe sa na kushton, ne për atë kemi menduar se në vitin 2015 ne mund të përgatitemi për fillim të zbatimit.

Edhe në vendet e rajonit, do të thotë, në Shqipëri, ky është një pilot projekt, në një regjion të caktuar. Nuk është projekt që aplikohet në tërë territorin. Dhe këtu mund të jetë një projekt në regjion të caktuar si model që aplikohet.

Në kuptimin e respektimit të drejtave të njeriut, unë mendoj që nuk ka asnjë cenim, sepse pala ose personi deklarohet para gjykatës për pranimin e kësaj mase dhe nuk ka person që është para gjykatës dhe që nuk ka qejf me ndej te shtëpia, pra në familjen e vet, në oborrin e vet ose në lagjen e vet dhe e zgjedh burgun si masë. Pra, nuk kam person, e kam fjalën për vepra të lehta, e jo për krime që mund të jenë të rënda.

Shpenzimet, mos të flasim, janë për afat të gjatë dhe për afat të gjatë unë mendoj se është e dobishme dhe është e domosdoshme për këtë shoqëri, duke pasur parasysh zhvillimin e teknologjisë, e tjera, e tjera dhe unë besoj që në këtë aspekt ne nuk do të kemi problem, sidomos kur të kihet parasysh se personi me vetë dëshirë e pranon një masë të tillë.

Pra, dallimi është i madh se personat e liruar me kusht, do të thotë nuk përfshihen decidivisht në këtë masë. Paneli mundet, do të thotë, ta shqiptojë

një masë. Ju e keni pa edhe këtu se është e kufizuar, domethënë mbikëqyrja për një vit.

(Ndërhyrje)

Po shiko, nëse paneli, nëse pala, nëse personi është... sepse ne kemi të bëjmë me dy lloj të personave, që u shqiptohet, pra personat që janë të liruar me kusht dhe personat që janë në procedurë.

Nëse paneli e ka shqiptuar për një masë për mbikëqyrje nga Shërbimi sprovues, apo e ka mbikëqyrë do të thotë shërbimi sprovues, këta edhe tash janë të mbikëqyrur. Tash vetëm do të thotë, mbikëqyrja është elektronike për vendin ku do të rri dhe lirinë ku e ka.

Pra, ne e kemi parasysh që këta persona, sidomos lirimi me kusht, pa hyrë në vepra të tjera, që do të thotë ka marrëveshje në mes personave, gjykatës e prokurorive, paneli për lirim me kusht i liron kryesisht personat që mendohet se janë risocializuar ose mendohet se qëllimi i dënimit e ka mbërri efektin e vet.

Ndërsa personat tjerë, do të thotë, që janë në procedura, janë persona që organet ose gjykatat tona vendosin për ta përcjellë. Këtu e kemi parasysh, siç e thash edhe më herët, dënimin me kusht, me trajtim të detyrueshëm, rehabilitues në ente të caktuara. E ju e dini qysh mund të ndodhë dhe sa mundet ta përcjell gjykata atë punë dhe e keni parasysh mbikëqyrjen, ndërrimin e vendbanimit ose largimi i personave që janë të liruar me kusht jashtë shtetit e tjera, do të thotë thyerja e atyre vendimeve, vendet publike, frekuentimi e tjera, alkoolistët, droga e tjera, do të thotë iu kufizohet njerëzve hapësira ose territori i caktuar ku mund të shkojë, por është këtu ose dhuna në familje apo gjetiu, ka urdhër mbrojtës dhe urdhër të mbrojtjes emergjente. Nuk mund, do të thotë, ky person me krye aktin në rast se e keni kufizuar se nuk mund të shkojë në territor të caktuar. E në rast se e ka thyer atë rregull, për 15 minuta do të thotë ai person ndëshkohet duke pasur parasysh se kjo është përcjellje permanente, personat që e pranojnë këtë masë nuk besoj se mundën bash lehtë të tentojnë ta thejnë, duke i pasur parasysh pasojat që mund t'i ketë, në revokimin e vendimit e tjera.

Ne thamë, kjo puna e projekteve tjera nuk ka të bëjë me këtë. Kjo vetëm se e ndihmo, do të thotë, edhe Shërbimin sprovues edhe punën me më burgosur,

me risocializimin dhe sensibilizimin e opinionit me një masë të tillë, prandaj ne insistojmë që normalisht, jo me ngutje, dhe nuk jemi për t'u ngutur, por ne insistojmë që të kihet parasysh ato që janë thënë në ligj, të kihet parasysh gjithçka që mund të korrigjohet eventualisht në atë që nuk janë shumë të qarta, por nuk besoj se ka nevojë ne aq gjatë të presim ta bëjmë një ligj i cili reflekton, do të thotë, në shumë segmente të shoqërisë sonë edhe në humanizim të dënimeve, edhe në përcjellje, edhe në menaxhim të rasteve, por edhe në pikëpamje buxhetore sigurisht në vitin e parë do të reflektojë, por në vitet tjera absolut do të ketë kosto buxhetore simbolike.

Unë ju falënderoj për këtë, dhe konsideroj se jemi të interesuar për të vazhduar punën, të vazhdohet kontributi i secilit, normalisht me vërejtje e sugjerime konkrete, në mënyrë që ky ligj të jetë përmbajtjesor, të jetë ligj që nuk ka defekte dhe ne s'jemi të interesuar të ngutemi e të kemi defekte në këtë ligj, prandaj ky ligj në vitin 2015 të fillojë të implementohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit shumë!

Ju falënderoj edhe një herë të gjithëve që e keni pasur të arsyeshme dhe iu keni përgjigjur ftesës së Komisionit. Është vlerësim i yni por është edhe tendencë e jona që të jemi të hapur sidomos me publikun dhe palët e interesit që shprehen zakonisht për çdo projektligj të caktuar.

Të gjitha këto që u thanë, do të merren seriozisht nga grupi punues dhe nga Komisioni. Unë vetëm sa për informacion, ne e kemi filluar punën, ky është takimi i tretë i radhës, takim me karakter të dëgjimit publik. Kemi angazhuar edhe ekspertë nga fusha e drejtësisë dhe do të jenë pjesë e grupit punues, edhe nga prokuroria edhe nga gjykata.

Kemi planifikuar po ashtu që të shohim një prej vendeve që e ka implementuar apo është në fazën e implementimit të këtij projektligji, ndoshta edhe një prej vizitave do të jetë, si vendi më i lehtë në qasje, që është Shqipëria.

E dyta, unë po ju premtoj edhe në emër të Komisionit, ne do të punojmë bashkërisht në punë edhe ekipore dhe tendenca jonë është që ligjet që më shumë janë në aspektin profesional, por që janë në interes të përgjithshëm, pa dallime politike, po kjo është edhe natyra e Komisionit që po shihet edhe nga puna dhe angazhimi, prandaj do të kërkojmë edhe nga Kuvendi nëse ka

nevojë për periudhë shtesë kohore sepse afatet kohore janë afruar për këtë projektligj, për arsye se në projektligj të parashihet hyrja në fuqi një vit tjetër e jo në vitin 2014 dhe do t'i analizojmë në detaje të gjitha këto shqetësime që u ngritën, eventualisht edhe ndonjë mendim tjetër që besoj nuk do të jetë më radikal e të shohim se si do të ecë apo të procedohet ky projektligj, a do të shkojë për lexim të dytë apo do të lihet për një fazë tjetër. Mirëpo, interesi ynë është që ky ligj të jetë i implementueshëm dhe i zbatueshëm në praktikë.

Ju faleminderit shumë dhe mirupafshim në takime tjera.

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë